



VENDIM

Nr. 8 Datë 02.02.2011

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “ENERGY PARTNERS AL”
SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 gërma “g”, nenit 5 pika 2 dhe neneve 13 e 14 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 02.02.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “ENERGY PARTNERS AL” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “ENERGY PARTNERS AL” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “ENERGY PARTNERS AL” sh.p.k në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 8 Datë 02.02.2011

PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “ENERGY PARTNERS AL”
SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____

